

VENDIM
Nr. 532, datë 6.8.2014

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 116, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR STATUSIN E NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE AKTUALË QË PËRFITOJNË STATUSIN E
NËPUNËSIT CIVIL SIPAS LIGJIT NR. 152/2013, “PËR NËPUNËSIN CIVIL””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 67, pika 8, e 69, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 6, të kreut III, shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“6/1. Punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë të emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë të emëruar, me kushtin që, brenda një afati 2-vjeçar, t’i plotësojnë këto kushte.

6/2. Për punonjësit, të cilët nuk i plotësojnë kushtet, sipas pikës 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, në përfundim të afatit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës, i cili vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.”.

2. Pas pikës 5, të kreut IV, të shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Afati 2-vjeçar, i përmendur në pikën 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, fillon nga data 1 shtator 2014.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama